

e veta, së bashku me bashkëfshatarët e tyre, i braktisën shtëpitë dhe u nisën drejt pyllit. Përgjatë tërë kohës, forcat serbe shtënin mbi ta. Në afërsi të pyllit, një plumb e ka qëlluar dhe e ka plagosur rëndë Rifatin në shpinë. Muhameti i strehoi gratë dhe fëmijët në pyll dhe, më pas, me të vëllain u kthyen që ta merrnin axhën e vet. Në çastin kur u përkul që ta merrte axhën Rifat, një plumb e ka qëlluar në qafë dhe e ka vrarë në vend. Edhe Rifati së shpejti ndërroi jetë nga plaga vdekjeprurëse. Familjarët i kanë varrosur Rifatin dhe Muhametin një ditë më vonë në varrezat e Çitaku/Çitak.

Burimet: deklarata N.Ç, FDH-15954; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.287.A, FDH-5823; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, X, 369; J. Martinsen, *Registri..*, FDH-26092; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 151, FDH-23816.

Ajmane (Sejdi Babaj) Çitaku

(1924, shqiptare nga Çitaku/Çitak, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, shtatë fëmijë)

Kur forcat serb kanë hyrë sërish në mëngjesin e datës **18.05.1998** në **Çitak/Çitak**, Ajmanja e moshëthyer me gratë dhe fëmijët e familjes së vet u strehuan në bodrumin e kushëririt Jetishit. Në orët në vijim dëgjoheshin gjëmimet dhe bombardimet e fuqishme. Nga ora 13:00, ajo doli jashtë që të mbushte ujë për fëmijët. Nuk u kthye më. Pas katër orë, të shtënat pushuan dhe familjarët e saj dolën nga bodrumi. E kanë gjetur trupin e pajetë të Ajmanes në oborr. E kishin qëlluar me dy plumba në gjoks. Një ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Ajmanen në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata H.Ç, FDH-15953; deklarata S.Xh, FDH-11522.

Dostana (Bogić) Šmigić

(3.06.1957, serbe nga komuna Skënderaj/Srbica, nëpunëse administrative, e pamartuar)

Dostana punonte në Entin për Punësim në Skënderaj/Srbica. Në datën **18.05.1998**, ajo me makinën e vet u nis për në Leçinë/Leočina, ku mbahej përkujtimi me rastin e vdekjes së gjyshes së saj. Duke kaluar nëpër **Klinën e Epërme/Gornja Klina**

e ka takuar mikun Vlado Kostićin, i cili e priste autobusin. I ftoi që t'i bashkëngjitej, por ai refuzoi. Sipas mendimit të tij, udhëtimi me autobus ishte më i sigurt. Vladoja ishte i fundit që e shihte Dostanen të gjallë. Zhdukja e Dostanes është regjistruar nga KNKK-ja dhe lënda e saj është sistemuar në lëndën me numër BLG-803509-01.

Burimet: deklarata V.Š, FDH-18312; deklarata D.V, FDH-18994; deklarata N.Š, FDH-18995; deklarata R.Š, FDH-18996; deklarata S.Š, FDH-17560; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 161, FDH-23816; *Dnevnik od 2. do 8. septembra*, Ilustrovana politika, 12.09.1998, FDH-32222; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795.

Ramadan (Abaz) Loshi

(8.08.1927, shqiptar nga Runiku/Rudnik, komuna e Skënderajt/Srbica, murator, tetë fëmijë)

Ramadani me bashkëshorten Hatmanen dhe vajzat Lutfijen dhe Shehrijen jetonin në Runik/Rudnik. Tri ditë pas sulmit të forcave serbe ndaj fshatit fqinj të Padalishtës/Padalište, më **18.05.1998**, Ramadanin u nis për në këtë fshat për një vizitë të vëllezërit dhe farefisi, të cilët jetonin atje. U nis me linjën e rregullt të autobusit Mitrovicë/Kosovska Mitrovica – Pejë/Peć. Nuk kishte njohuri që farefisi i tij e kishte braktisur më herët fshatin [Padalishtë/Padalište]. Të nesërmen, familjarët mësuan se Ramadanin e kishin vrarë. Trupin e tij të pajetë e kishte gjetur një kushërre e tij në oborrin e shtëpisë së vet [Padalishtë/Padalište], kur u kthye në fshat më 18.05.1998, për ta lëshuar bagëtinë në kullotë. Familjarët e kanë varrosur Ramadanin në varrezat e Padalishtës/Padalište.

Burimet: deklarata S.L, FDH-15964; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.287.A, FDH-5823; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, X, 369.

Dejan (Obrad) Stoilković

(20.02.1973, serb nga Ropotova e Madhe/Veliko Ropotovo, komuna e Kamenicës/Kosovska Kamenica, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas mbarimit të Shkollës për Punë të Brendshme, Dejan u punësua në vitin 1992